

VENDIM
Nr.73, datë 21.1.2009

PËR LICENCIMIN E KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT “DENTARIUM-AL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 7, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e kolegjit profesional privat “Dentarium-AL”, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji profesional privat “Dentarium-AL”, do të ofrojë programin e studimit, të ciklit të parë, në “Protezist stomatolog”, në formën e studimit me kohë të plotë. Programi i studimit realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja e tij do të jetë tri vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), në fushën e arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet kolegji profesional privat “Dentarium-AL”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Kolegji profesional privat “Dentarium-AL”, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi, programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Kolegji profesional privat “Dentarium-AL”, duhet t’i nënshtrohet, procesit të akreditimit institucional dhe të programit të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha